

# *Propaganda dhe imazhi në rastin e incidentit të Kumanovës*

*Dr. Hasan Saliu\**

## **Abstrakt**

Vendet synojnë të krijojnë imazh pozitiv për veten edhe nëpërmjet propagandës të ushtruar nga aktorë shtetërorë, duke u prezantuar si viktimë e ndonjë agresioni, me qëllim të përfitimit të simpatisë nga të tjerët. Një rast i tillë i prezantimit të vetes si viktimë dhe demonizimit të palës tjetër ishte incidenti i armatosur i fillimmajit në Kumanovë të Maqedonisë, e cila ngjarje pati një mbulim të madh mediatik nga mediat ndërkombëtare. Në këtë incident pala maqedonase synoi ta prezantojë veten viktimë e një agresioni nga qytetarë ekstremistë nga Kosova. Mediat ndërkombëtare raportuar gjerësisht për këtë incident, ndërsa një publik i huaj gjerësisht i painformuar në detaje për zhvillimet ballkanike ndodh shpesh që të ndikohet nga efekti primacy i mesazhit, qoftë ky edhe i rrejshëm.

Punimi do të trajtojë mbulimin e madh mediatik ndërkombëtar që ka pasur ky incident i armatosur ku u vranë 18 veta parë nga perspektiva e imazhit për shqiptarët në përzgjedhësi dhe Kosovën në veç anti.

Hipoteza kryesore që shtrohet këtu është se incidenti i Kumanovës, pavarësisht paqartësive dhe dyshimeve të mëdha për ngjarjen në vetvete, megjithatë në publikët e largët ka ndikuar negativisht për imazhin ndërkombëtar të shqiptarëve.

Punimi ka për qëllim të analizojë mbulimin që i kanë bërë mediat e fuqishme ndërkombëtare; mesazhi primar që është dhënë dhe nëse janë dhënë informacione të mëvonshme shpjeguese për paqartësitë e këtij studenti. Mesazhi primar, qoftë edhe mesazh propagandues, vlerësohet të jetë më efektiv sesa përgënjeshtrimi i mëvonshëm në rastet kur marrës mesazhi është një publik jo fort i informuar me atë zhvillim apo që edhe nuk ka interesim të shtuar për ato zhvillime.

**Fjalë kyç:** *propagandë, agenda setting, imazh, media globale, Kosovë, komunikim politik*

---

\* *Dr. Hasan Saliu, Fakulteti i Komunikimit Masiv, Kolegji AAB, Prishtinë. E-mail: hasan.saliu@aab-edu.net*

## Hyrje

Rasti i incidentit të armatosur në Kumanovë të Maqedonisë ku u vranë 18 veta, kryesisht shqiptarë nga Kosova dhe disa policë maqedonas, kërkon një trajtim ndërdisiplinor, për të shpjeguar se si shtetet varësisht nga rrethanat gjeopolitike, përdorin edhe propagandën mediatike për të përqendruar vëmendjen në disa çështje dhe për të zhvendosur vëmendjen nga problemet të tjera me të cilat përballen. Gjendja në Maqedoni para se të ndodhte ky incident, ishte mjaft e tendosur ndërmjet opozitës dhe qeverisë maqedonase. Në kohën kur ndodhi incidenti, kishte muaj të tërë që opozita publikonte regjistrime telefonike nga bisedat e qeveritarëve të Maqedonisë, përfshirë kryeministrin, ministrin e brendshëm, shefin e policisë sekrete etj., ku dëgjoheshin bisedat e zyrtarëve të lartë qeveritarë të përfshirë në krime ekonomike, fshehje vrasjesh dhe atentatesh nga vetë ministrat qeveritarë, falsifikime zgjedhjesh etj<sup>1</sup>. Skandali me përgjimet masive që i kishte bërë qeveria ndaj më shumë se 20 mijë qytetarëve të Maqedonisë, një pjesë e të cilave përgjime kishte rënë në duart e opozitës, tensionoi së tepërmi gjendjen ndërmjet opozitës dhe qeverisë, me protesta të opozitës, por edhe dhunë policore dhe arrestime të protestuesve opozitarë<sup>2</sup>. Përshkallëzimi i gjendjes ndodhi më 5 maj kur filluan protestat pasi regjistrimet telefonike dëshmonin se si krerët më të lartë qeveritarë kanë fshehur vrasjen e një të riu të kryer nga zyrtarë shtetërorë në vitin 2011 dhe fshehjen e një atentati të dyshuar ndaj një gazetari maqedonas në vitin 2013. Përplasjet ishin aq të mëdha sa që asnjëherë në historinë e Maqedonisë nuk kishte

---

<sup>1</sup> *The Guardian*, *Fears for Macedonia's fragile democracy amid 'coup' and wiretap claims*, 27 shkurt, 2015: <http://www.theguardian.com/world/2015/feb/27/fears-macedonias-fragile-democracy-amid-coup-wiretap-claims>

*Voice of America*, "New Opposition Protests in Macedonia Follow Violent Clashes", May 6, 2015. në: <http://www.voanews.com/content/ap-macedonia-protests/2752876.html>

<sup>2</sup> *NYT*, *Protesting Macedonians Demand Government's Resignation*, 17 maj, 2015. <http://www.nytimes.com/aponline/2015/05/17/world/europe/ap-eu-macedonia-protests.html>

ndodhur që të dalin bashkë shqiptarë e maqedonas për të protestuar kundër qeverisë dhe të valëvisnin bashkërisht në një tubim flamurin maqedonas dhe flamurin shqiptar <sup>3</sup>. Dhe, në këtë kohë të kulmit të përplasjes brendamaqedonase që nga pavarësia e këtij shteti më 1991, krejt papritmas ndodhi vrasja e 18 vetave në Kumanovë, 8 policëve dhe 10 shqiptarëve në një përleshje të armatosur. Kjo ndodhi vetëm katër ditë pasi kishin filluar edhe protestat e dhunshme kundër qeverisë. Shumica e të vrarëve ishin nga Kosova, shumica e të arrestuarve dhe krerëve të grupit ishin gjithashtu nga Kosova.

## ***Metodologjia***

Trajtesa nuk ka për qëllim të merret me çështjet se përse erdhën qytetarët nga Kosova në Maqedoni për të luftuar; a ishin të manipuluar apo jo, apo të tradhtuar? Në këtë trajtim nuk paraqet interes pyetja nëse kishin ardhur me pagesë apo pa pagesë dhe pyetje të tjera të lidhura me grupin nga Kosova. Ajo që na intereson këtu dhe që shtrohet si pyetje kërkimore, është vetëm nëse incidenti i Kumanovës ka mundur ta dëmtojë imazhin e Kosovës duke pasur parasysh ato që mediat ndërkombëtare kanë transmetuar për këtë incident.

Në monitorim janë marrë disa media, globalet BBC, CNN, e pastaj Euronews dhe Al Jazeera. Dy të parat kanë transmetuar nga 2-4 kronika në dy ditët e para pas vrasjeve që ndodhën në Kumanovë, ndërsa Euronews dhe Al Jazeera me nga dy raporte, duke mos llogaritur këtu përsëritjen e kronikave varësisht nga edicionet e lajmeve. Janë marrë këto media, sepse gjatë monitorimit është vërejtur se shumë media të tjera kanë transmetuar kronikat e këtyre medieve, ose ia janë referuar këtyre mediave. Gjithashtu, janë marrë në shqyrtim këto media për shkak se përplotësojnë një mozaik informues dhe shumëkulturore.

---

<sup>3</sup> BBC, *Macedonia protests: Anti-Gruevski rally in Skopje*, në: <http://www.bbc.com/news/world-europe-32771233>

## Çfarë kanë raportuar mediat globale për Kumanovën?

CNN më 10 maj informon se janë vrarë disa policë maqedonas nga një grup i quajtur terrorist në një qytet të banuar me shqiptarë dhe maqedonas, ndërsa civilët janë evakuuar nga vendi i ngjarjes<sup>4</sup>.



Fig. 1. Raportimi i CNN për incidentin në Kumanovë

Burimi: <https://www.youtube.com/watch?v=EFQJy8oOoz8>

Më vonë po këtë ditë, CNN duke iu referuar burimeve zyrtare qeveritare në Shkup, informon se të vrarët janë policë dhe bëhet fjalë për pesë veta. Kjo ka ndodhur në një përleshje të armatosur të policisë me një grup terrorist i përbërë prej rreth 70 vetave. Ngjarja ka ndodhur në qytetin që, siç e përshkruan CNN, “Kumanova është vendbanimi i shqiptarëve etnikë minoritarë, të cilët janë kryesisht myslimanë. Maqedonia është shumicë e krishterë ortodokse.”<sup>5</sup> Gjithashtu aty kujtohet se ky vend ka kaluar nëpër një konflikt të armatosur ndëretnik në mes shqiptarëve dhe maqedonasve në vitin 2001. Në një lidhje tjetër nga Shkupi, CNN informon se janë vrarë më shumë 22 veta në një përleshje me një grup terrorist, në vendin që ka probleme ndëretnike mes shqiptarëve dhe maqedonasve. Gjithashtu në këtë lidhje prononcohet diplomati maqedonas, Nikolla Dimitrov, i

<sup>4</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=EFQJy8oOoz8>

<sup>5</sup> <http://edition.cnn.com/2015/05/10/europe/macedonia-police-raid-balkan-flashpoint/>

cili flet se si Maqedonia ka mbetur pikë nevralgjike në Ballkan pas luftës ndërmjet forcave shtetërore dhe shqiptarëve kryengritës në vitin 2001<sup>6</sup>.



Fig. 2. CNN raporton për 22 të vrarë

Burimi: <http://edition.cnn.com/videos/world/2015/05/11/exp-macedonia-unrest-leaves-22-dead.cnn>

Me titullin “Vriten policë maqedonas në përleshje me terroristët”, BBC informon më 10 maj se janë vrarë pesë policë nga një grup terrorist, të cilët, sipas ministrisë së brendshme maqedonase, kanë ardhur nga një vend fqinj. Më pas raporti thekson se ngjarja ka ndodhur në afërsi të kufirit serbo-kosovar, duke shtuar se një muaj më parë rreth 40 shqiptarë nga Kosova kishin hyrë në Maqedoni dhe kishin sulmuar e dëmtuar stacionin Goshincë afër kufirit<sup>7</sup>. Në këtë raport citohet ministrja e brendshme maqedonase, Gordana Jankulovska, e cila është shprehur se policët maqedonas janë vrarë nga sulmet me bomba dhe armë automatike, nga njerëz të ardhur nga jashtë vendit dhe të cilët kanë pasur për qëllim të sulmojnë edhe institucionet shtetërore në Maqedoni. Ajo i ka quajtur policët e vrarë “heronj që kanë dhënë jetën në mbrojtje të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa ka shtuar se disa nga sulmuesit janë vrarë dhe 20 të tjerë janë dorëzuar<sup>8</sup>.

---

<sup>6</sup> <http://edition.cnn.com/videos/world/2015/05/11/exp-macedonia-unrest-leaves-22-dead.cnn>

<sup>7</sup> <http://www.bbc.com/news/world-europe-32674121>

<sup>8</sup> Po aty.

Një ditë më vonë, shumë media perëndimore transmetonin raportin e AFP-së se nga 30 të akuzuarit për terrorizëm, 18 të kapurit nga policia në Kumanovë janë nga Kosova që kanë hyrë ilegalisht në Maqedoni<sup>9</sup>. BBC po këtë ditë gjithashtu transmeton raportin e AFP-së e cila i referohet agjencisë maqedonase të lajmeve (MIA) se “Maqedonia akuzon 30 veta për terrorizëm, pas përleshjeve Kumanovë<sup>10</sup>. Po më 11 maj, me titullin “Maqedonia fajëson kosovarët për përleshjet vdekjeprurëse në Kumanovë”, BBC raporton se autoritetet maqedonase kanë identifikuar udhëheqësit e grupit të armatosur të cilët janë shtetas të Kosovës. Duke cituar autoritetet maqedonase, sipas BBC-së, Sami Ukshini, Beg Rizaj, Dem Shehu, Muhamet Krasniqi dhe Mirsad Ndrecaj, ishin udhëheqësit e grupit të armatosur, shtetas të Kosovës, ndërsa edhe 14 trupat e pajetë të uniformuar, gjithashtu thuhet se janë nga Kosova<sup>11</sup>. Ngjashëm raporton edhe Al Jazeera, duke e plotësuar kronikën me raportin e marrë nga Reuters, se *kosovarët ishin fajtorë për humbjet e 22 jetëve në Kumanovë*. Ky televizion arab, Programi në gjuhën angleze, citon autoritetet maqedonase sipas të cilëve ky ka qenë një incident “shumë serioz dhe Maqedonia ka qenë cak i sulmit terrorist..., ndërsa sulmuesit kanë qenë shqiptarë, ish-pjesëtarë të UÇK-së”<sup>12</sup>.

Në dy ditët e para pas vrasjeve, informacionet që kryesisht u përcillleshin opinioneve ndërkombëtare nga këto media globale, ishin se në Maqedoni nga një sulm i armatosur terrorist, janë vrarë pesë policë, ndërsa numri i përgjithshëm i viktimave është 22<sup>13</sup>. Bëhet fjalë për një sulm terrorist ndaj policisë, ndërsa terroristët, sipas autoriteteve maqedonase që citonin mediat ndërkombëtare, kishin ardhur nga Kosova. Pas dorëzimit të grupit të armatosur, dy ditë më

---

<sup>9</sup> <http://www.abc.net.au/news/2015-05-12/macedonia-charges-30-with-terrorism-after-kumanovo-shooting/6461990>

<sup>10</sup> <http://www.bbc.com/news/world-europe-32695909>

<sup>11</sup> <http://www.bbc.com/news/world-europe-32680904>

<sup>12</sup> <http://www.aljazeera.com/news/2015/05/macedonia-policemen-killed-battle-armed-group-150509213341943.html>

<sup>13</sup> Vetëm pas disa ditësh ministria e brendshme maqedonase tha se nuk janë 22 të vrarë, por 18 dhe se gabimi, sipas tyre, është bërë se disa trupa të pajetë janë numëruar dy herë.

vonë, këto media nuk patën më ndonjë kronikë apo raport për Kumanovën, edhe pse ky incident u quajt nga opozita, faktorë ndërkombëtarë dhe të tjerë, si një inskenim i qeverisë maqedonase për ta zhvendosur vëmendjen nga protestat e opozitës dhe skandalet me përgjimet masive.

### *Efekti i raportimeve*

Përgjithësisht ndodh që efekti i mesazhi goditës të jetë shumë më ndikues dhe të mbahet mend, sesa shpjegimi eventual i mëvonshëm. Në këtë rast, lajmi se ka ndodhur një sulm i armatosur në një vend europian dhe janë vrarë 18 apo 22 veta, dhe se flitet për terroristë, përplasje mes shqiptarësh muslimanë dhe maqedonasish ortodoksë, është tërheqës për publikun perëndimor në këtë kohë pasigurie, terrorizmi fetar, luftërave në viset arabe, pas Charlie Hebdo. Për mediat ndërkombëtare paraqet interes të shtuar raportimi për vrasjen e 22 vetave në kontinentin europian, pesë prej të cilëve ishin policë dhe të tjerët, siç thuhej, terroristë. Por, zhvillimet e mëpastajme për sqarimin e ngjarjes, sigurisht që nuk paraqesin interes as për mediat ndërkombëtare, e aq më pak për publikun ndërkombëtar. Madje, edhe sikur të konfirmohet në të ardhmen se grupi i futur nga Kosova në Maqedoni ka qenë i manipuluar nga segmente qeverire maqedonase, kjo nuk paraqet ndonjë mundësi për të përmbysur efektin e lajmit fillestar se “një grup terrorist nga Kosova futet në Maqedoni dhe vret policë, në një incident ku mbeten të vrarë 22 veta...”. Nga mbulimi mediatik i ngjarjes, efekti negativ është arritur, imazhi i shqiptarëve apo i Kosovës, është goditur. Pra, *efekti parësor* (primacy effect)<sup>14</sup> ka bërë të veten.

---

<sup>14</sup> Teoricienët e komunikimeve masive kanë shtruar pyetjen nëse janë më efikase argumentet fillestare në mbështetje të një situatë, apo argumentet e mëvonshme apo përfundimtare në mbështetje të një situatë të kundërt? Këtu fjala është për ato që njihen si efekte *primacy* nëse vërtetohet se efikasiteti më i madh është i argumenteve fillestare dhe efekti *recency* nëse rezultojnë më ndikues argumentet përfundimtare. Ndodh kryesisht që efekti *primacy* të ketë më shumë ndikim ndaj audiencës sesa ai efekti

Në rastet kur marrësi i mesazhit nuk ka informacion dhe ngjarra është e papritur që në këtë rast marrës është publiku i ndryshëm në botë, *efekti i sërishëm* (recency) që në këtë rast do të ishte eventualisht se “grupi është mashtruar, manipuluar nga policia sekrete për qëllime të brendshme politike”, sërish përgënjeshtrimi eventual që ka pak mundësi të ndodhë, nuk do të kishte efektin e përmirësimit të imazhit të dëmtuar. Lajmi i parë goditës ka gjithmonë më shumë efekt sesa përgënjeshtrimi i mëvonshëm nëse ndodh<sup>15</sup>.

Por, edhe sikur të ndodhte një gjë e tillë, ajo madje, vështirë se do të gjente mbulim mediatik në krahasim me lajmin e mëhershëm negativ për imazhin e Kosovës se “vriten 22 veta në Maqedoni nga një përplasje me terroristë kosovarë”. Kjo nuk do të ndodhë edhe për një arsye tjetër praktike: lajmet për *vrasje e terroristë* në këtë kontekst social global janë më tërheqës dhe goditës për publikun e huaj sesa qoftë edhe nëse ndodh në të ardhmen përgënjeshtrimi se *vrasjet e para kaq kohësh në Maqedoni kanë qenë të instrumentalizuara nga vetë pushteti*.

Me fjalë të tjera, pavarësisht qëndrimit përçmues që mund të kemi nga qëndrimet tradicionale filozofike e metafizike, megjithatë, industria për formimin e imazhit të mirë ose dëmtimit të imazhit të tjetrit varet nga një sërë masash e strategjish komunikuese, nga angazhimi i specialitëve të marrëdhënieve publike, shpesh edhe propagandës etj<sup>16</sup>. Në këtë kuadër bën pjesë edhe djallëzimi (demonizimi) i kundërshtarit apo i armikut në politikën e jashtme, si një strategji komunikuese për ta dëmtuar tjetrin dhe për ta prezantuar veten si mbrojtës i parimeve demokratike, veprimeve racionale,

---

*recency*. (Mauro Wolf, *Teorie delle comunicazioni di massa*, Bompiani, Milano, 1996, f. 38)

<sup>15</sup> Më gjerësisht për këtë shih edhe: Hovland, C.I., Lumsdale, A.A. & Sheffield, F.D, *Experiments on Mass Communication: Studies in Social Psychology in World War II: Volume III*, Princeton University Press, Princeton, 1949.

<sup>16</sup> John Hartley, *Communication, Cultural and Media Studies*, Routledge, 2004. f. 108.



ndërsa veprimet e tjetrit për t'i përafuar me të keqen e përgjithshme, me punën e djallit<sup>17</sup>.

### ***Përfundim***

Këto media, u morën me Kumanovën vetëm dy-tri ditët e para pas incidentit, kur flitej për numrin e të vrarëve, kur autoritetet maqedonase thoshin se grupi i armatosur i ardhur nga Kosova ka kërkuar të destabilizojë Maqedoninë, se janë terroristë etj. Më pas, kur opozita maqedonase hodhi dyshime për ngjarjen dhe vetë të arrestuarit filluan të thoshin se kanë qenë të manipuluar nga policia sekrete e Maqedonisë me qëllim që të zhvendoset vëmendja: nga tensionet brendamaqedonase – te rreziku që i vjen Maqedonisë nga shqiptarët nga brenda dhe Kosova nga jashtë, mediat ndërkombëtare nuk u morën më me zhvillimet në Maqedoni. Me fjalë të tjera, opinionin ndërkombëtar ka marrë mesazhin se Maqedonia ka qenë viktimë e një ndërhyrjeje të një grupi të armatosur shqiptar nga Kosova, të ndihmuar nga shqiptarë nga Maqedonia. Madje, mediat ndërkombëtare raportojnë ato dy ditë pas incidentit, duke cituar autoritetet maqedonase, se fjala është për një grup terrorist i ardhur nga Kosova, duke dhënë shpjegime në kronikat e tyre se shqiptarët janë myslimanë, ndërsa maqedonasit janë ortodoksë. Me fjalë të tjera, për incidentin në Kumanovë disa publikë të huaj përgjithësisht kanë

---

<sup>17</sup> Njëri ndër studiuesit eminentë të realizmit politik në marrëdhëniet ndërkombëtare, Hans Morgenthau, e trajton demonizimin si pjesë të politikës së jashtme të shteteve. Në gjashtë parimet kryesore të realpolitikës, në njërin prej tyre (në të dytën), Morgenthau veçon demonizimin si njërin ndër parimet e politikës dhe marrëdhënieve në mes shteteve. Duke arritur të shpallë armikun si pjesëtar të ideologjisë së drejt, veprime të se keqes, shtetet synojnë të bindin edhe vendet neutrale apo të treta, për një vend të caktuar. Prandaj, “duke eliminuar një herë e mirë grupe të caktuara njerëzish ose individësh, mendohet se mund të eliminohen edhe problemet e përfaqësuara nga ta”.

Me gjerësisht shih: David R. Willcox, *Propaganda, the Press and Conflict - The Gulf War and Kosovo*, Routledge, London and New York f. 6.; Hasan Saliu, *Komunikimi në diplomacinë publike – Soft power-i dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës*, AAB, Prishtinë, 2015, f. 167-172.

marrë informacione se në Maqedoni ka trazira të armatosura dhe viktime në njerëz, por kjo ka ardhur si pasojë e hyrjes së një grupi të armatosur nga Kosova, e banuar me shqiptarë myslimanë, që kanë sulmuar maqedonasit ortodoksë, për ta destabilizuar atë vend jostabil dhe i cili madje ka kaluar një konflikt të armatosur ndëretnike në vitin 2001.

### ***Bibliografi dhe webliografi***

Hartley, John. *Communication, Cultural and Media Studies*. Routledge. 2004.

Hovland, C.I., Lumsdale, A.A. & Sheffield, F.D. *Experiments on Mass Communication: Studies in Social Psychology in World War II*. Volume III. Princeton University Press. 1949.

Saliu, Hasan. *Komunikimi në diplomacinë publike – Soft power-i dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës*. AAB. Prishtinë: 2015.

Willcox, David R. *Propaganda, the Press and Conflict - The Gulf War and Kosovo*. Routledge. London and New York: 2005.

Wolf, Mauro. *Teorie delle comunicazioni di massa*. Bompiani. Milano:1996.

The Guardian, "Fears for Macedonia's fragile democracy amid 'coup' and wiretap claims", 27 shkurt, 2015. në: <http://www.theguardian.com/world/2015/feb/27/fears-macedonias-fragile-democracy-amid-coup-wiretap-claims> (vizituar: 22 gusht, 2015)

Voice of America, "New Opposition Protests in Macedonia Follow Violent Clashes", 6 maj, 2015. në: <http://www.voanews.com/content/ap-macedonia-protests/2752876.html> vizituar: 20 gusht, 2015)

New York Times, "Protesting Macedonians Demand Government's Resignation". 17 maj, 2015. në: <http://www.nytimes.com/aponline/2015/05/17/world/europe/ap-eu-macedonia-protests.html> (vizituar: 17 gusht, 2015)

BBC, "Macedonia protests: Anti-Gruevski rally in Skopje", 17 maj, 2015. në: <http://www.bbc.com/news/world-europe-32771233> (vizituar: 17 gusht, 2015)

<https://www.youtube.com/watch?v=EFQJy8oOoz8> (vizituar: 20 gusht, 2015)

<http://edition.cnn.com/2015/05/10/europe/macedonia-police-raid-balkan-flashpoint/> (vizituar: 17 gusht, 2015)

<http://edition.cnn.com/videos/world/2015/05/11/exp-macedonia-unrest-leaves-22-dead.cnn> (vizituar: 17 gusht, 2015)

<http://www.bbc.com/news/world-europe-32674121> (vizituar: 20 gusht, 2015)

<http://www.abc.net.au/news/2015-05-12/macedonia-charges-30-with-terrorism-after-kumanovo-shooting/6461990> (vizituar: 17 gusht, 2015)

<http://www.bbc.com/news/world-europe-32695909> (vizituar: 20 gusht, 2015)

<http://www.bbc.com/news/world-europe-32680904> (vizituar: 20 gusht, 2015)

<http://www.aljazeera.com/news/2015/05/macedonia-policemen-killed-battle-armed-group-150509213341943.html> (vizituar: 20 gusht, 2015)